

KAMËZ

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE



KONTRATA SOCIALE

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane



gadc@gadc.org.al



+355 4 22 555 14



www.popalbania.info



+355 68 20 59 301



+355 4 22 555 14

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP 2019, është një nismë e rrjetit të 11 organizatave të shoqërisë civile shqiptare në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme lokale të 30 Qershorit 2019.

POP 2019 synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre.

POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2017. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, me fonde të Ambasadës Suedeze në Tiranë.

POP 2019 do të organizohet në bashkitë Durrës, Fier, Kamez, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP 2019 synon:

Të nxisë dialogun mes zgjedhësve dhe kandidatëve, por edhe ndërmjet kandidatëve vetë, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët do të mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre dhe do të ftohen të nënshkruajnë Kontratën Sociale mes tyre dhe qytetarëve në çdo bashki.

Përmes mjeteve të avokimit / lobimit rrjeti POP 2019 do të përpiqet të arrijë rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjesht një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e ardhshëm të bashkive.

Të informojnë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, do t'u ofrojë qytetarëve shqiptarë një paraqitje shumë të nevojshme të ofertave të partive politike. Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit.

Aktivitetet që do të organizohen në kuadër të POP 2019, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njëri-tjetrin dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike.

Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP 2019 do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre, pasi zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike në periudhën parazgjedhore është e rëndësishme. POP 2019 është një mundësi për partitë politike që të paraqesin programet e tyre të tregojnë se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të monitorohen pas Zgjedhjeve Lokale 2019 nga Rrjeti i organizatave të POP 2019 dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.

ORGANIZATAT

- Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës
- Qendra Rinore Vlorë
- ACPD/Qendra "Aulona", Vlorë
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz
- Epoka e Re, Fier
- Intelktualët e Rinj "Shpresë", Shkodër
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
- Qendra Rinore për Progres, Kukës
- Integrimi, Aktivizimi dhe Ndërgjegjësimi i të Rinjve, Pogradec
- Lëvizja "Mjaft"

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

Banorë të Bashkisë Kamëz u përfshinë në 5 Forume, të zhvilluara gjatë muajit prill 2019 me qëllim identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej 5 Forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, si dhe studentë, shtëpiake apo persona të grupeve të marginalizuara.

Pjesëmarrja sipas gjinive

Burra 33 %

Gra 67 %

Në çdonjërin prej forumeve të zhvilluara qytetarët diskutuan gjerësisht mbi 17 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:



Shërbimet publike



Zhvillimi ekonomik vendor



Dimensioni social




Demokracia vendore

Për secilën prej 17 çështjeve objekt diskutimi qytetarët dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi çështjet që përbëjnë prioritet për ta e për rrjedhojë duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në tre grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;
3. **Vijueshmëri**, përfshin çështje të cilat kanë arritur zhvillimin e pritshëm nga komuniteti dhe për to nevojitet vetëm ruajtje e të njëjtit standart nga të zgjedhurit vendorë.



21 janë prioritetet e komunitetit të prezantuara gjerësisht në vijim, sipas shkallës së rëndësisë që i ka dhënë vetë komuniteti, për të cilat do të lobohet për të qenë pjesë e axhendës së të zgjedhurve të rinj vendor, sikurse përmbushja e të cilave do të monitorohet në vijim nga vetë komuniteti.

PRIORITETET E KOMUNITETIT

Grupi i parë / NDËRHYRJE PRIORITARE

Janë **15 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR



- Planifikimi strategjik
- Incentivat për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës
- Nxitja e bizneseve të të rinjve dhe grave
- Nxitja e punësimit
- Niveli i taksave/tarifave në raport me shërbimin

SHËRBIMET PUBLIKE



- Ndriçimi
- Pastrimi
- Gjelbërimi
- Kopshte dhe çerdhe
- Kanalizimet

DIMENSIONI SOCIAL



- Grupe në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror¹
- Romët dhe Egjiptianët

DEMOKRACIA VENDORE



- Transparenca në vendimarrje
- Pjesëmarrja në vendimarrje

Grupi i dytë / NDËRHYRJE DISI PRIORITARE

Janë **5 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë disi prioritare.

DIMENSIONI SOCIAL



- Gratë

SHËRBIMET PUBLIKE



- Rrugët dhe Trotualet
- Furnizimi me ujë të pijshëm
- Shkollat

DEMOKRACIA VENDORE



- Informimi dhe komunikimi

Grupi i tretë / VIJUESHMËRIA

Komuniteti i Bashkisë Kamëz të gjitha çështjet i konsideronte si prioritare apo disi prioritare, ndaj nuk u krijua grupi i tretë për Vijueshmërinë.

¹ Në këto grupe përgjithësisht përfshihen: të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjet përfituese të ndihmës ekonomike, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, persona të pastrehë, fëmijët pa kujdes prindëror, përdorues të alkoolit apo drogave etj.

● ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR ●

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Të gjitha njësitë e përfshira në forumet e organizuara në bashkinë Kamëz listojnë si prioritet planin strategjik për zhvillim territorial dhe ekonomik të kësaj bashkie.

Prioritet 1. Informacion për qytetarët në lidhje me egzistencën, përmbajtjen sidomos në lidhje me gratë, të rinjtë dhe grupeve në nevojë.

INCENTIVAT PËR NXITJEN E BIZNESIT DHE KRIMIN E VENDEVE TË REJA PUNËS

Ka pak informacion mbi incentivat që përdor Bashkia për të nxitur biznesin dhe krijuar vende të reja pune. Nxitja e biznesit konsiderohet prioritar nga komuniteti me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës. "Dy prej të rinjve pjesëmarrës u shprehën se e panë më të arsyeshme të hapnin një biznes në Tiranë sesa në Kamëz (ku banojnë), për shkak të lehtësirave fiskale në mbështetje të bizneseve të reja." Ka mungesë strategjie për nxitjen e biznesit dhe për pasojë nxitjen e punësimit. Bizneset ndjejnë një barrë të rëndë fiskale e cila sipas tyre nuk lejon zgjerimin e tyre.

Prioritet 2: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Prioritet 3: Informimi i gjerë i grave dhe të rinjve mbi programet për nxitjen e biznesit dhe procesin e aplikimit për tu përfshirë në këto programe.

NXITJA E PUNËSIMIT

"Banorët shprehën se nxitja e punësimit është një nga prioritetet e banorëve dhe që duhet të jetë prioritar në axhendat e kandidatëve për Kryetar Bashkie në Kamëz.²" Të rinjtë shprehën se ka nevojë për programe të cilat nxisin punësimin si p.sh. praktika profesionale pranë administratës etj. Për grupet me nevoja të veçanta (invalidët, komuniteti rom dhe egjiptian etj.) e ndjejnë më shumë mungesën e mbështetjes.³ Gratë dhe vajzat janë më të disavantazuara në lidhje me punësimin.

Prioritet 4: Programet e Bashkisë për nxitjen e punësimit të priorizojnë grupet më pak të avantazuara në tregun e punës:

- Të rinjtë e sapo diplomuar.
- Gratë.
- Gratë viktime të dhunës në familje.
- Romët.
- Egjiptianët

NIVELI I TAKSAVE/TARIFAVE NË RAPORT ME SHËRBIMIN

Përfaqësuesit e komunitetit në të gjitha Forumet u shprehën të pakënaqur me nivelin e taksave/tarifave. Ata u shprehën se ato janë të larta dhe nuk justifikojnë shërbimin apo cilësinë e tij. Në mënyrë të veçantë tarifat e ujit të pijshëm nuk i përgjigjen cilësisë dhe shërbimit. Gjithashtu sipas komunitetit të kësaj bashkie ka shumë penalizime të padrejta për ata që nuk paguajnë taksat. "Duhet të rishikohen nivelet e pagesës për disa taksa sepse për banorët janë të papërballueshme."⁴

Prioritet 5: Rivlerësim i nivelit të taksave dhe tarifave vendore, si dhe krijimi i lehtësive në nivelin e taksave/tarifave për kategoritë në nevojë



2 Njësia administrative Bathore 3 Njësia administrative Paskuqan
4 Njësia administrative Paskuqan

SHËRBIMET PUBLIKE

NDRIÇIMI

Përfaqësuesit e komunitetit në të gjitha njësitë theksuan se shërbimi i ndriçimit të rrugëve është shumë i dobët dhe ata si banorë janë shumë të pakënaqur. Sipas banorëve shpesh ka pasur raste të vjedhjes së kabllave të enegjisë dhe riparimi ka kërkuar shumë kohë. Megjithatë në rrugët kryesore të bashkisë Kamëz, ndriçimi është përmirësuar në brendësi të lagjeve dhe në rrugë dytësore ka mungesë të theksuar.

Prioritet 6: Adresimi me prioritet i rregullimit të ndriçimit dhe i mirëmbajtjes.

Paskuqan: Rrugët ndriçohen vetëm nga dritat e bizneseve përgjatë rrugëve. Edhe në rrugët e rregulluara rrishtazi, ndriçimi nuk është i përhershëm. Dritat ndizen me raste.

Bathore: Ndriçimi është problematik si në rrugët kryesore ashtu edhe në rrugët e lagjeve. Banorët shprehin se ndihen të pasigurtë nga mungesa e ndriçimit në zonat e banuara.

PASTRIMI

Cilësia e pastrimit është e ndryshme në zona të ndryshme. Megjithatë banorët shprehin se ka nevojë për përmirësim të dukshëm. Edhe në zonat ku ka kosha, ka probleme me pastrimin. Banorët e Kamzës shprehin mjaft të pakënaqur në lidhje me pastrimin. Ata shprehin se nuk ka kosha mbeturinash për grumbullimin e tyre dhe se nuk zbatohet orari i vendosur nga bashkia për ditët kur kalon makina për të grumbulluar mbeturinat.

Prioritet 7: Kontrolli më i shpeshtë i shërbimit të pastrimit, shtimi i numrit të koshave dhe i frekuencës së mbledhjes nga makinat e grumbullimit.

Kamëz: Ka kosha mbeturinash dhe makinat që mbledhin ato çdo ditë. Pak më problematike është situata në disa prej lagjeve ku nuk ka kosha, por që Bashkia ka vendosur një vend grumbullim dhe kalon makina me grafik.

Paskuqan: Ka nevojë për të vendosur kosha mbeturinash në disa pika, sepse mungesa e tyre shkakton mjaft ndotje dhe aromë të keqe. Kjo sjell si shkak edhe krijimin e kopeve me qen rrugësh (që mund të sjellin rrezik për banorët).

Bathore: Duhet të shtohet frekuenca e kalimit të makinave të grumbullimit.

GJELBËRIMI

Banorët, përfaqësues të komunitetit të kësaj bashkie, shprehen të pa kënaqur në lidhje me gjelbërimin dhe zonat rekreative. Ka mungesë investimesh në lidhje me këtë çështje. Banorët shprehin se paguajnë takse gjelbërimi për një shërbim të cilin nuk e marrin. Mungojnë parqet për fëmijë apo dhe mjediset çlodhëse.

Prioritet 8: Investimi për hapësira të gjelbra dhe parqe për fëmijët dhe komunitetin.

KOPSHTET DHE ÇERDHE

Megjithatë banorët e bashkisë Kamëz nuk kishin vërejtje për infrastrukturën apo mirëmbajtjen, pothuajse të gjithë personat e përfshirë në këtë forum në të gjitha njësitë theksuan se ka nevojë për çerdhe dhe kopshte sepse ato që janë nuk mbulojnë të gjitha nevojat e banorëve. Kopshtet janë shpesh brenda ambjentëve të shkollave gjë e cila sjell problem në administrimin e nxënësve (hyrjet daljet).

Prioritet 9: Investimi në ngritjen e kopshteve dhe çerdheve të reja si dhe largimi i kopshteve nga ambjentet e shkollave.

FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET

Furnizimi me ujë të pijshëm është përmirësuar. Shumica e lagjeve kanë furnizim me ujë të pijshëm. Problematike janë kanalizimet në disa zona, ka nevojë për ndërhyrje sepse shpesh ato përmbyten gjatë shirave. Kanalizimet kanë probleme me në disa zona si Frutikulturë e cila për shkak të kanalit ka përmbytje gjithmonë në sezon shirash.⁵

Prioritet 10: Adresimi me prioritet dhe zgjidhja e problemeve me kanalizimet

● DEMOKRACIA VENDORE ●

TRANSPARENCA NË VENDIMARRJE

Banorët shprehen se ka nevojë për përmirësim të dukshëm në lidhje me transparencën e pushtetit lokal. Ata shprehen se nuk janë në dijeni të njoftimeve që bëhen nga bashkia dhe nuk njoftohen për mbledhjet e Këshillit Bashkiak, apo për vendimet që merren në to. Gjithashtu komuniteti kërkon të informohet mbi datat e takimeve konsultuese apo të shpalljes së fondeve në investime të ndryshme.

Prioritet 11: Informimi i komunitetit në lidhje me takime apo mbledhje të cilat janë të hapura dhe kanë të bëjnë me çështje të vendimmarrjes.

PJESËMARRJA NË VENDIMARRJE

Lajmërimet për të marrë pjesë në takime për çështje vendimmarrëse nuk janë egzistente dhe komuniteti nuk është pjesëmarrës në takime të tilla. Ata shprehen se nuk ndjehen të përfaqësuar në vendimmarrjen lokale, nuk kanë dijeni për mbledhjet, për takimet publike apo konsultimet që bën bashkia. Të rinjtë shprehen se kanë nevojë të ndjehen të përfaqësuar në vendimmarrje. Disa prej tyre shprehen se kanë dëgjuar për ngritjen e një grupi rinor pranë Bashkisë nuk janë në dijeni se si janë zgjedhur këta të rinj dhe si funksionon ky grup. Ata duan që zëri i tyre të ndihet në vendimmarrjen lokale.⁶

Prioritet 12: Lajmërimi i komunitetit për takime publike që organizon bashkia dhe dhënia e mundësisë që të shprehin opinionet e tyre dhe të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Prioritet 13: Ngritja e politikave lokale për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje.



● DIMENSIONI SOCIAL ●

GRUPE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR

Pothuajse njëzëri banorët e kësaj bashkie konfirmojnë se nuk kanë dijeni nëse kjo bashki ka shërbime sociale të ngritura për individë në nevojë për shërbime, të tilla si shërbim në familje për persona me aftësi të kufizuara ose të moshuar, qendra komunitare për familjen dhe fëmijën, qendra ditore për persona me aftësi të kufizuara, për të moshuar. Gjithashtu banorët nuk ishin të informuar në lidhje me shërbimet reabilituese të ngritura nga kjo bashki për viktimat e dhunës në familje.

Prioritet 14: Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për grupet në nevojë.

Prioritet 15: Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet reabilituese të ngritura nga bashkia për viktimat e dhunës në familje.

ROMËT DHE EGJIPTIANËT

Komuniteti i bashkisë Kamëz nuk ka dijeni në lidhje me programe të veçanta për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe përfshirjen sociale të këtyre grupeve.

Prioritet 16: Informimi i komunitetit në lidhje me programe të veçanta për komunitetin Rom dhe atë Egjiptian.



Grupi i dytë / NDËRHRYJE DISI PRIORITARE

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

RRUGËT DHE TROTUARET

Megjithë vlerësimin disi pozitiv që është bërë nga komuniteti në lidhje me rrugët dhe trotuaret, përsëri, ka problematika të cilat banorët i kanë karakterizuar si disi prioritare, sidomos për rrugët e brendshme në njësi të ndryshme.

Prioritet 17: Investimi dhe adresimi për përmirësimin e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistikës.

Bathore: Banorët kanë shqetësim mungesën e kapakëve të pushtave.

Ka nevojë për përmirësimin e sinjalistikës rrugore, sidomos pranë shkollave. Në disa zona mungojnë trotuarët.

Kamez: Ka nevojë për investime si p.sh. në Frutikulturë, Rr. Albanët, Rr. OSBE, Harku i Triumfit etj. Gjithashtu ka probleme me trotuaret si dhe sinjalistikën rrugore në disa zona.

Paskuqan: Banorët shprehen se situata e rrugëve është përmirësuar disi, rruga kryesore në Paskuqan është rregulluar, por kanë nevojë të rregullohen rrugët nëpër lagje si Rr. "Themistokli Gërmenji" etj, ndërkohë problematike në disa prej rrugëve është gjerësia e trotuarëve.

FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

Furnizimi me ujë të pijshëm është përmirësuar në Kamëz. Shumica e lagjeve kanë furnizim me ujë të pijshëm. Banorët kanë nevojë për përmirësimin e cilësisë së ujit, në disa zona është i ndotur. Ndërkohë që në Paskuqan furnizimi me ujë të pijshëm është problematik. Vetëm një zonë ka furnizim të rregullt me ujë. Ndërkohë lagje të tjera nuk kanë furnizim dhe uji nuk është i konsumueshëm.

Prioritet 18: Rregullimi i furnizimit me ujë të pijshëm, kontrolli sistematik i procesit dhe ndërhyrja për përmirësimin e cilësisë.

SHKOLLAT

Në të gjitha Forumet u vlerësua disi pozitivisht gjendja e shkollave egzistuese, por banorët nxorën në pah disa çështje shqetësuese në lidhje me këtë çështje. Nevoja për të shtuar numrin e shkollave u theksua nga pjesa më e madhe e Forumeve si dhe përmirësimi i shërbimit.

Prioritet 19: Ndërhryje infrastrukture në shkolla egzistuese dhe ngritja e shkollave të reja.

Bathore: Shkollat nuk furnizohen me ujë të pijshëm, p.sh. shkolla në Dritas. Ka nevojë për ndërtimin e disa shkollave sepse ka mbipopullim me nxënës.

Kamëz: Ka nevojë për disa shkolla të reja se në shkollën "Ibrahim Rugova" bëhet mësimi me turne. Gjithashtu disa shkolla nuk kanë furnizim me ujë të pijshëm.

Paskuqan: Në disa shkolla ka mungesa të furnizimit me ujë (shkolla Jashar Hoxha) si dhe ka nevojë për më shumë investime në mirëmbajtjen e shkollave.

● DEMOKRACIA VENDORE ●

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Banorët shprehen se niveli i komunikimit dhe informimit është disi i mirë në lidhje me marrjen e dokumentave/informacioneve / kopje të akteve/vendimeve të bashkise. Por, edhe për këtë shërbim banorët e këtij komuniteti nuk e vlerësojnë se puna e bërë nga ana e pushtetit lokal është shumë e mirë. Ata kërkojnë më shumë bashkëpunim dhe lehtësira për marrjen e këtyre informacioneve.

Prioritet 20: Lehtësimi i procedurave dhe komunikimi i vazhdueshëm me komunitetin sidomos për marrjen e akteve dhe vendimeve të bashkisë.

● DIMENSIONI SOCIAL ●

GRATË

Në përgjithësi, banorët e bashkisë Kamëz kishin disi informacion më lidhje me programet e kësaj bashkie për adresimin e dhunës me bazë gjinore. Jo shumë informacion në lidhje me fushtatat ndërgjegjësuere kundër dhunës ndaj gruas. Sipas këtij komuniteti ka nevojë për rritjen e barazisë gjinore si në Këshill Bashkiak edhe në punësimet në administratë.

Prioritet 21: Informimi në mënyrë të vazhdueshme i komunitetit në lidhje me programet me bazë gjinore, sidomos për fushatat ndërgjegjësuere kundër dhunës.

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE